

## **Marrëveshje e Përgjithshme për Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike**

E lidhur më 17.08.2018 ("Data e hyrjes në fuqi ")

ndërmjet

**KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE  
SHQIPTARE sh.a.**

Dhe

(këtu e më poshtë referuar bashkërisht si "**Palët**" dhe veç e veç si "**Pala**")

### **Përmbledhje**

Palët kanë një interes të përbashkët për të krijuar një bazë ligjore që rregullon transaksionet e tyre të ndërsjella tregtare për blerjen, shitjen, dorëzimin dhe pranimin e energjisë elektrike. Për këtë qëllim, të dyja palët bien dakord për dispozitat e mëposhtme, të cilat – në lidhje me përmbajtjen dhe formën – janë bazuar në "Marrëveshjen e Përgjithshme" të EFET-it në lidhje me Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike", Versioni 2.1(a), i datës 21 shtator 2007 (këtu e më poshtë referuar si "Marrëveshja e Përgjithshme e EFET-it"; e cila është e disponueshme të shkarkohet [www.efet.org](http://www.efet.org)).

### **§ 1 Objekti i Marrëveshjes së Përgjithshme**

**Objekti i Marrëveshjes:** Kjo Marrëveshje e Përgjithshme ("MP"), (e cila përfshin anekset e saj) rregullon të gjitha transaksionet që Palët do të kryejnë për blerjen, shitjen, lëvrimin dhe pranimin e energjisë elektrike (çdo transaksion është një "Kontratë individuale"). Të gjitha kontratat individuale dhe kjo MP do të formojnë një marrëveshje të vetme ndërmjet Palëve (të referuara kolektivisht si "Marrëveshja"). Dispozitat e kësaj MP përbëjnë një pjesë përbërëse të çdo Kontrate Individuale.

### **§ 2 Përkufizimet dhe Struktura**

- 1. Përkufizime:** Termat e përdorur në Marrëveshje do të kenë kuptimet e përcaktuara në Aneksin 1.
- 2. Mospërputhje:** Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet kushteve të një kontrate individuale (qoftë e evidentuar në një konfirmim ose me mjete të tjera) dhe dispozitave të kësaj MP, kushtet e Kontratës Individuale do të mbizotërojnë për qëllimet e asaj Kontrate Individuale.
- 3. Interpretimi:** Kokat dhe titujt janë përdorur vetëm për lehtësi dhe nuk kanë asnjë ndikim në interpretimin e Marrëveshjes.



4. **Referenca në kohë:** Referencat për kohën do të jenë sipas orës së Evropës Qendrore (CET). Kjo do të përfshijë orën dimërore të Evropës Qendrore dhe orën Verore të Evropës Qendrore sipas rastit.

### § 3 Lidhja dhe konfirmimi i Kontratave Individuale

1. **Lidhja e Kontratave Individuale:** Kontratat individuale mund të lidhen në çdo formë komunikimi dhe do të jenë ligjërisht të detyrueshme dhe të zbatueshme që pas përcaktimit të kushteve të kësaj Kontrate Individuale.
2. **Konfirmimet:** Në rastin kur një Kontratë Individuale nuk është lidhur me shkrim, të dyja Palët do të konfirmojnë me shkrim mirëkuptimin e tyre (çdo konfirmim me shkrim përbën një "Konfirmim"). Konfirmimi me shkrim nuk do të përbëjë një kërkesë për një Kontratë Individuale ligjërisht të vlefshme. Konfirmimi do të përmbajë informacionin e përcaktuar në dhe do të jetë në thelb në formën e fletës së konfirmimit të aplikueshëm nga që i janë bashkëngjitur kësaj MP si Aneksi 2. Shitësi do t'ia dërgojë Blerësit Konfirmimin e një Kontrate Individuale në gjuhën angleze. Një faksimil ose mesazh i dërguar përmes postës elektronike mjafton për të përmbushur kërkesën e konfirmimit me shkrim në përputhje me Nenin 3.
3. **Kundërshtimet ndaj konfirmimeve:** Pala B do të shqyrtojë menjëherë kushtet e secilit Konfirmim dhe nëse ato ndryshojnë nga kuptimi i kushteve të Kontratës Individuale të zbatueshme, do të njoftojë pa vonesë Palën tjetër për çdo mospërputhje. Në këtë rast, kushtet e rëna dakord me shkrim do të zbatohen në masën që këto kushte ndryshojnë nga kushtet kundërshtuese.

### § 4 Detyrimet parësore për Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike

1. **Lëvrimi dhe Pranimi:** Në përputhje me çdo Kontratë Individuale, Shitësi do të planifikojë, shesë dhe lëvrojë, ose do të bëjë që të lëvrohet, dhe Blerësi do të planifikojë, blejë dhe pranojë, ose do të bëjë që të pranohet, Sasia e Kontratës në Pikën e Lëvrimit; dhe Blerësi do t'i paguajë shitësit Çmimin përkatës të Kontratës.
2. **Përkufizimi i Planit:** "Plani" do të nënkuptojë, sipas rastit, veprimet e nevojshme që një Palë do të kryejë për të përmbushur detyrimet e saj përkatëse të dorëzimit dhe pranimit, të cilat mund të përfshijnë emërimin, planifikimin, njoftimin, kërkesën dhe konfirmimin me palën tjetër, me agjentët e tyre përkatës të caktuar dhe përfaqësuesit e autorizuar, dhe me Operatorin e Rrjetit, sipas rastit, të Sasisë së Kontratës, Kapacitetit të Kontratës, Pikës së Dorëzimit, Planit të dorëzimit, Periudhës Totale të Furnizimit dhe çdo kusht tjetër përkatës të kontratës individuale në përputhje me të gjitha rregullat e zbatueshme të Operatorit të Rrjetit dhe praktikat dhe procedurat e tjera të zakonshme të industrisë.

### § 5 Matja e dorëzimit, transmetimi dhe rreziku

1. **Transferimi i të drejtave të titullit:** Lëvrimi do të kryhet duke vënë në dispozicion Sasinë e Kontratës sipas Kapacitetit të Kontratës në Pikën e Lëvrimit. Lëvrimi dhe marrja e Sasisë së Kontaktit dhe transferimi nga Shitësi te Blerësi i të gjitha të drejtave të titullit pa pretendime të padëshiruara në lidhje me to, do të bëhet në Pikën e Lëvrimit. Lëvrimi i energjisë elektrike në përputhje me këtë Marrëveshjeje duhet të kryhet si një transaksion sipas planit.
2. **Rreziqet e Shitësit dhe të Blerësit:** Shitësi do të mbulojë të gjitha rreziqet që lidhen me dhe do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose tarifë të vendosur ose lidhur me Planifikimin, transmetimin dhe lëvrimin e Sasisë së Kontratës deri në Pikën e Lëvrimit. Blerësi do të mbulojë të gjitha rreziqet që lidhen me dhe do të





jetë përgjegjës për çdo kosto ose tarifë të vendosur për ose lidhur me pranimin dhe transmetimin e Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Lëvrimit.

3. **Rryma/Frekuenca/Voltazhet:** Energjia elektrike do të lëvrohet në Pikën përkatëse të Lëvrimit me rrymën, frekuencën dhe voltazhin e aplikueshëm, siç është rënë dakord në Kontratën Individuale dhe të pranuar nga Operatori kompetent i Rrjetit.
4. **Matja e Lëvrimeve dhe Marrjes në dorëzim të energjisë elektrike:** Secila Palë është përgjegjëse për të siguruar që lëvrimet dhe marrja në dorëzim të energjisë elektrike maten ose verifikohen me mjete që mund të evidentohen në mënyrë të arsyeshme në përputhje me procedurën e Operatorit të Rrjetit që rregullon Pikën përkatëse të Lëvrimit.
5. **Dokumentacioni aktual i Lëvrimeve dhe Marrjeve në Dorëzim:** Sipas kërkesës së arsyeshme, një Palë:
  - i. do t'i sigurojë palës tjetër dokumentacionin që disponon ose kontrollon përmes së cilit evidentohen Planet, sasitë, lëvrimet dhe marrjet në dorëzim të energjisë elektrike me qëllim për të përcaktuar shkaku dhe çdo devijimi që mund të konstatohet midis kushteve të një Kontrate Individuale dhe lëvrimeve dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike; dhe
  - ii. do të përdorë përpjekjet e arsyeshme dhe të kujdesshme për t'i kërkuar dhe për të marrë nga Operatori i Rrjetit dhe do të ndajë me Palën kërkuese çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të harmonizuar mospërputhjet ndërmjet flukseve të Planifikuara dhe aktuale të energjisë elektrike.
6. **Rimbursimi i kostove të jashtme:** Në rast se një Palë, me kërkesë të palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga pala tjetër, kryen shpenzime të arsyeshme të jashtme për të verifikuar që pala tjetër nuk ka përmbushur siç duhet detyrimet e saj sipas kushteve të Kontratës Individuale, këto shpenzime do të rimbursohen sipas kërkesës, nga Pala që nuk ka përmbushur detyrimet;
7. **Planet e Lëvrimit:** Energjia elektrike do të lëvrohet sipas Planeve të Lëvrimit të specifikuara në secilën Kontratë Individuale;

## **§ 6 Mospërmbushja e detyrimeve për shkak të Forcës Madhore**

1. **Përkufizimi i Forcës Madhore:** Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, "Forca Madhore" nënkupton një dukuri përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala pretenduese"), të cilën ajo nuk mund ta shmangë ose kapërcejë në mënyrë të arsyeshme dhe që e pengon Palën pretenduese të përmbushë detyrimet e saj të lëvrimit ose pranimin, duke përfshirë, por pa u kufizuar, për një ose më shumë nga shkaqet e mëposhtme:
  - (i) Ndërprerja e komunikimit ose mosfunksionimi i sistemeve kompjuterike të Operatorit(ve) përkatës të Rrjetit, i cili e pengon Palën pretenduese të përmbushë detyrimet e saj të lëvrimit ose pranimin; ose
  - (ii) Përzullimi i dorëzimit ose pranimin nga Operatori përkatës i Rrjetit ose mosrespektimi i detyrimeve të Palës pretenduese në lidhje me Planifikimin sipas Kontratës Individuale.
2. **Çlirimi nga lëvrimi dhe Detyrimet e Pranimin:** Në rast se një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore që të përmbushë detyrimet e saj të lëvrimit ose pranimin sipas një ose më shumë Kontratave Individuale dhe kjo palë është në përputhje me kërkesat e pikës 6.3, Pala Pretenduese do të konsiderohet se nuk ka kryer asnjë shkelje ose mospërmbushje dhe do të çlirohet (dhe jo thjesht do të pezullohet) nga këto detyrime për periudhën kohore dhe në masën që kjo Forcë Madhore pengon përmbushjen e detyrimeve të saj;

3. **Njoftimi dhe Zbutja e Forcës Madhore:** Pala pretenduese, pasi të vihet në dijeni për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër, sa më shpejt që të jetë e mundur, për fillimin e Forcës Madhore dhe, në masën që është e disponueshme në atë kohë, duhet t'i japë kësaj të fundit një vlerësim jodetyrues lidhur me masën dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj për të përmbushur detyrimet. Pala pretenduese do të përdorë të gjitha përpjekjet e arsyeshme komerciale për të zbutur efektet e Forcës Madhore dhe, gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do ta përditësojë palën tjetër në mënyrë të arsyeshme, kur dhe nëse ka, për masën dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj për të përmbushur detyrimet;
4. **Efektet e Forcës Madhore mbi Palën tjetër:** Në rast dhe në masën që detyrimet e lëvrimin të Shitësit çlirohen nga Forca Madhore, do të çlirohen edhe detyrimet përkatëse të Blerësit që lidhen me pranimin dhe pagesën. Në rast dhe në masën që detyrimet e pranimit të Blerësit çlirohen nga Forca Madhore, do të çlirohen edhe detyrimet përkatëse të Shitësit që lidhen me lëvrimin;
5. **Zgjidhja e MP-së:** Në rast kur në lidhje me një Kontratë Individuale, ka pasur një ndikim negativ mbi detyrimet e Palës Pretenduese për më shumë se tridhjetë (30) ditë rresht ose për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë në total brenda një periudhe prej një viti kalendarik, atëherë Pala që nuk është Pala Pretenduese do të ketë të drejtën ta zgjidhë këtë kontratë duke e njoftuar me shkrim për Palën Pretenduese. Zgjidhja e Kontratës nuk do të ketë ndonjë ndikim në të drejtat dhe detyrimet përkatëse të Palëve të cilat janë përcaktuar përpara datës së zgjidhjes së Kontratës. Megjithatë, pas datës së zgjidhjes, asnjëra palë nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj tjetrës në lidhje me pjesën e Periudhës Totale të Furnizimit, së cilës nuk i ka mbaruar ende afati, sipas kësaj Kontrate Individuale.

#### **§ 7 Masat korrigjuese lidhur me Moslëvrimin dhe Mospranimin**

1. **Moslëvrimi:** Në rastet kur Shitësi nuk arrin të lëvrojë Sasinë e Kontratës tërësisht ose pjesërisht në përputhje me kushtet e Kontratës Individuale dhe mospërmbushja e detyrimit nuk justifikohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosfunksionimi i palës tjetër, Shitësi do t'i paguajë Palës tjetër ("Blerësit") si kompensim për dëmet, një shumë për sasinë e palëvruar të energjisë elektrike të barabartë me prodhimin e:
  - (a) shumës, nëse është pozitive, me të cilën Çmimi i Kontratës do të tejkalojë çmimin, nëse ka, që Blerësi duke vepruar në mënyrë të arsyeshme është ose do të jetë në gjendje të blejë ose në të kundërt, të marrë në treg sasinë e palëvruar të energjisë elektrike; dhe
  - (b) sasisë së energjisë elektrike të palëvruar;

Kjo shumë do të rritet me kostot shtesë të transmetimit, si dhe kostot e shpenzimit e tjera të arsyeshme dhe të verifikueshme të kryera nga Blerësi si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e Shitësit.
2. **Mospranimi:** Në rastin kur Blerësi nuk pranon plotësisht ose pjesërisht Sasinë e Kontratës në përputhje me Kontratën Individuale dhe kur mospranimi nuk justifikohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mospërmbushja e detyrimeve të palës tjetër, Blerësi do t'i paguajë Shitësit si kompensim për dëmet, një shumë për sasinë e energjisë elektrike të papranuar të barabartë me prodhimin e;
  - (a) shumës, nëse është pozitive, me të cilën Çmimi i Kontratës do të tejkalojë çmimin me të cilin Shitësi është ose do të jetë në gjendje të shesë në treg sasinë e energjisë elektrike të papranuar duke vepruar në mënyrë të arsyeshme komerciale; dhe



(b) sasisë së energjisë elektrike të papranuar;

Kjo shumë do të rritet me kostot shtesë të transmetimit, si dhe kostot e shpenzimet e tjera të arsyeshme dhe të verifikueshme të kryera nga Shitësi si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e Blerësit.

3. **Shumat e pagueshme:** Shumat që duhet të paguhen sipas pikës 7 do të faturohen dhe do të paguhen në përputhje me pikën 12.

#### § 8 Pezullimi i Lëvrimit

Përveç çdo të drejte ose mjeti tjetër juridik në dispozicion të një Pale ("Pala që nuk është në mospërmbushje"), në rast se një Palë ("Pala në mospërmbushje") nuk kryen pagesat e duhura sipas Marrëveshjes, ose në rast se ofruesi i saj i mbështetjes me kredi nuk arrin të sigurojë, zëvendësojë ose rrisë shumën e Sigurimit të Performancës të kërkuar në përputhje me Marrëveshjen ose Dokumentin e Mbështetjes me Kredi, Pala që nuk është në mospërmbushje do të ketë të drejtë, jo më herët se tre (3) ditë pune pas njoftimit me shkrim të Palës në mospërmbushje që të ndërpresë menjëherë furnizimet e mëtejshme të energjisë elektrike (dhe të çlirohet (dhe jo thjesht të ndërpresë) nga detyrimet e saj themelore të lëvrimit) dhe të gjitha Kontratat Individuale deri në momentin kur Pala që nuk është në mospërmbushje, të marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë të gjitha interesat dhe shpenzimet e zbatueshme për vonesën) të të gjitha shumave të prapambetura që i duhen paguar Palës që nuk është në mospërmbushje.

#### § 9 Afati dhe të Drejtat e Zgjidhjes

1. **Afati:** Kjo MP do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi. Njëra nga Palët mund ta zgjidhë atë duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë përpara zgjidhjes (këtu e më poshtë referuar si "Zgjidhja e zakonshme") ose Zgjidhje për Arsye Materiale në përputhje me pikën 9.2 (këtu e më poshtë referuar si "Zgjidhja e Parakohshme"). Në rastin e Zgjidhjes së Zakonshme, MP do të mbetet ligjërish të detyrueshme për Palët derisa, por vetëm në lidhje me, të gjitha të drejtat dhe detyrimet tashmë të krijuara ose që ekzistojnë në përputhje me Marrëveshjen përpara datës së Zgjidhjes së Zakonshme të përmbushen plotësisht nga të dyja Palët;
2. **Zgjidhja për Arsye Materiale:** Marrëveshja mund të zgjidhet për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme (secila e konsideruar si një "Arsye Materiale"):
  - (a) Në rast të mospagimit, me kusht që ky mospagim nuk kryhet brenda dy (2) Ditë Pune pas kërkesës me shkrim;
  - (b) Në rast të mosofrimit të Mbështetjes me Kredi ose Sigurimit të Performancës, me kusht që ky mosofrim nuk rregullohet brenda tri (3) Ditë Pune pas kërkesës me shkrim;
  - (c) Mospërmbushja nga njëra Palë e detyrimit të saj për të ofruar ose pranuar energji elektrike sipas Kontratës Individuale për më shumë se shtatë (7) ditë rresht ose për më shumë se shtatë (7) ditë në total brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh;
  - (d) Deklarata ose garancia kur bëhet ose përsëritet ose konsiderohet se është bërë apo përsëritur nga një palë ose nga Ofruesi i saj i Mbështetjes me Kredi në një Dokument të Mbështetjes me Kredi vërtetohet të ketë qenë e pasaktë ose çorientuese në çfarëdo aspekti material kur është bërë ose përsëritur ose konsiderohet të jetë bërë ose të jetë përsëritur.

Arsyet e mësipërme materiale do të përbëjnë arsyet ekskluzive për Zgjidhjen e Parakohshme sipas pikës 9.2.

**3. Zgjidhja automatike:** Marrëveshja do të zgjidhet automatikisht pa kërkuar menjëherë njoftimin e zgjidhjes përpara kryerjes së aplikimit për procedurat mbi asetet e një Pale ose Ofruesit të saj të Mbështetjes me Kredi dhe kjo Palë ose Ofruesi i saj i Mbështetjes me Kredi, sipas rastit, ose;

- (a) e ka bërë vetë aplikimin, ose;
- (b) aplikimi është bërë nga një palë e tretë dhe një palë ose Ofruesi i saj i Mbështetjes së Kredisë, sipas rastit, nuk ka aftësi pagyese ose është e zhytur në borxhe, ose
- (c) aplikimi është bërë nga një palë e tretë dhe aplikimi nuk është tërhequr, refuzuar, shkarkuar, pezulluar ose kufizuar brenda katërmëdhjetë (14) ditëve. Pala që nuk preket nga zbatimi i këtyre procedurave ka të drejtë të kërkojë brenda kësaj periudhe Sigurimin e Performancës sipas pikës 14;

Në rast të zgjidhjes në përputhje me pikën 9.3, Pala që nuk preket nga zbatimi i këtyre procedurave është Pala Zgjidhëse.

#### **§ 10 Përlllogaritja e Shumës së Zgjidhjes**

- 1. Shuma e Zgjidhjes:** Në rast se kjo MP zgjidhet në përputhje me pikat 9.2 ose 9.3, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve sipas Marrëveshjes do të zëvendësohen nga detyrimi i njëres ose tjetrës Palë, sipas rastit, për t'i paguar Palës tjetër shumën e përlllogaritur në përputhje me pikën 10 ("Shuma e Zgjidhjes").
- 2. Pala Zgjidhëse** do të përcaktojë Shumën e Zgjidhjes duke përlllogaritur shumën (qoftë pozitive apo negative) të të gjitha Shumave të Shlyerjes për të gjitha Kontratat Individuale plus çdo ose të gjitha shumat e tjera të pagueshme ndërmjet Palëve sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje.
- 3. Pala përkatëse** do t'i paguajë Shumën e Zgjidhjes Palës tjetër brenda (3) Ditëve të Punës pas marrjes së njoftimit nga Pala Zgjidhëse.
- 4. Shuma e Shlyerjes:** "Shuma e shlyerjes" për një Kontratë Individuale do të jetë fitimi minus totalin e humbjeve dhe kostove të Palës Zgjidhëse si rezultat i zgjidhjes së Kontratës Individuale.
  - (a) "Kosto" janë tarifat e ndërmjetësimit, komisionet, kostot dhe shpenzimet e palëve të treta të kryera në mënyrë të arsyeshme nga Pala Zgjidhëse ose për zgjidhjen e ndonjë marrëveshjeje në bazë të së cilës ajo ka mbrojtur detyrimin e saj ose duke lidhur marrëveshje të reja që zëvendësojnë Kontratën Individuale të zgjidhur dhe të gjitha tarifat e arsyeshme ligjore, kostot dhe shpenzimet e kryera nga Pala Zgjidhëse në lidhje me zgjidhjen e Kontratës Individuale;
  - (b) "Fitimet" janë çdo shumë e barabartë me vlerën aktuale të përfitimit ekonomik për Palën Zgjidhëse, nëse ka (përfshirë kostot), që rezulton nga zgjidhja e Kontratës Individuale nga ana e saj, të përcaktuar në një mënyrë të arsyeshme komerciale; dhe
  - (c) "Humbje" janë një shumë e barabartë me vlerën aktuale të humbjes ekonomike për Palën Zgjidhëse, nëse ka (përfshirë kostot), që rezulton nga zgjidhja e Kontratës Individuale nga ana e saj, të përcaktuar në një mënyrë të arsyeshme komerciale.



Për përllogaritjen e shumave të shlyerjes, Pala Zgjidhëse mund, por nuk është e detyruar, të vlerësojë fitimet dhe humbjet e saj në Datën e Zgjidhjes së Parakohshme, sipas gjykimit të saj, pa hyrë në ndonjë transaksion zëvendësimi.

#### **§ 11 Kufizimi i Përgjegjësisë**

1. **Përrjashtimi i përgjegjësisë:** Sipas pikës 11.2 dhe 11.3, një Palë dhe punonjësit, nëpunësit, kontraktorët dhe/ose agjentët e saj, nuk janë përgjegjës ndaj Palës tjetër për ndonjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("Dëme"), duke përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi për shkak të parregullsive në furnizimin me energji elektrike sipas Kontratës Individuale, të shkaktuara nga Pala tjetër në përputhje me ose në lidhje me Marrëveshjen.
2. **Kufizimi i Përgjegjësisë:** Sipas pikës 11.3 dhe në rast të shkeljes së detyrimeve themelore kontraktuale për shkak të ndonjë gabimi dhe jo të bërë qëllimisht ose si rrjedhojë e neglizhencës së rëndë, përgjegjësia e secilës palë sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të përjashtohet, por do të kufizohet me dëmet e parashikuara në mënyrë të arsyeshme si pasojë e mundshme e ngjarjes dëmtuese në kohën e lidhjes së marrëveshjes së cenuar, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e njohura ose që duhet të ishin të njohura në atë kohë.
3. **Shkelje e qëllimshme, mashtrimi dhe të drejtat themelore:** Në Marrëveshje ose në pikën 11 nuk parashikohet asgjë për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë e një Pale për:
  - (a) Shkelje të qëllimshme;
  - (b) mashtrim, ose;
  - (c) neglizhencë të rëndë, ose;
4. **Detyra për të Zbutur Humbjet:** Secila Palë pranon se ka për detyrë të zbusë Dëmet dhe angazhohet se do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për të minimizuar çdo Dëm që mund të pësojë sipas ose në lidhje me Marrëveshjen.

#### **§ 12 Faturimi dhe Pagesa**

1. **Fatura:** Shitësi i energjisë elektrike sipas një Kontrate Individuale do t'i lëshojë palës tjetër gjatë muajit kalendarik pas lëvrimit të energjisë elektrike sipas Planit të Lëvrimit për muajin e mëparshëm një faturë, të shkruar në gjuhën shqipe dhe/ose angleze, në të cilën do të jenë të përcaktuara sasisë totale të energjisë elektrike që janë shitur sipas Kontratave Individuale në muajin e mëparshëm kalendarik. Sipas kërkesës së Ligjit Shqiptar mbi Tatimet dhe Rregulloreve për subjektet shqiptare, me kusht që çmimi i kontratës të përcaktohet në monedhë tjetër përveç Lekut, për qëllime faturimi, në faturë do të përcaktohet vlera e monedhës tjetër (siç është rënë dakord nga Palët) dhe ekuivalenti i tij i shprehur në lekë.
2. **Pagesa:** Në ose përpara ditës së njëzetë (20) të muajit kalendarik ose në rast se nuk është ditë pune, menjëherë në Ditën pasardhëse të punës ("Data e Pagesës"), një Palë që është e detyruar të mbulojë shumën e faturës, do të paguajë, me transfertë bankare, me fonde lirisht të disponueshme, shumën e përcaktuar në faturë në adresën e pagesës ose llogarinë bankare të dhënë nga Pala tjetër. Kryerja e këtyre pagesave, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe, do të bëhet në EURO dhe dërguesi do të paguajë tarifat e veta bankare.

3. **Netimi i Pagesave:** Në rast se kërkohet që secila prej palëve t'i paguajë njëra-tjetrës çdo ditë një ose më shumë shuma në të njëjtën monedhë sipas një ose më shumë Kontratave Individuale dhe këto shuma duhet të paguhet, atëherë, këto shuma do të mbledhen për secilën Palë dhe Palët do të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse të pagesës nëpërmjet netimit. Në këtë rast Pala, nëse ka, që ka një shumë totale më të madhe, do t'i paguajë Palës tjetër diferencën midis shumave që i detyrohen.
4. **Interesi i vonuar:** Interesi për pagesat e vonuara do të mbledhet nga, dhe duke përfshirë, Datën e Pagesës deri, por duke përjashtuar, datën e kryerjes së pagesës. Për gjashtë muajt e parë të vitit, interesi i vonës do të jetë sipas normave të interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane në mbledhjen e fundit të vitit të kaluar, të rritura me tetë për qind. dhe për gjashtëmuajorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit aktual, duke shtuar tetë për qind.

### § 13 TVSH-ja dhe Taksat

1. **TVSH:** Të gjitha shumat e referuara në këtë MP janë të përjashtuara nga çdo TVSH e aplikueshme. Trajtimi i TVSH-së për dhënien e fuqisë do të përcaktohet në përputhje me ligjet e TVSH-së të juridiksionit ku do të kryhet transaksioni i tatueshëm për qëllime të TVSH-së. Në rastin e TVSH-së, nëse TVSH-ja është e pagueshme për ndonjë shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në në normën e aplikueshme herë pas here; me kusht që kjo shumë do të kërkohet të paguhet vetëm pasi Shitësi ta pajisë Blerësin me një faturë të vlefshme TVSH-je (e zbatueshme në juridiksionin e furnizimit) në lidhje me atë shumë. Shitësi do ta pajisë Blerësin me çdo faturë të vlefshme shtesë të TVSH-së në masën e lejuar me ligj, siç kërkohet për qëllimet e kësaj MP.
2. **Taksat e tjera:** Të gjitha shumat e referuara në këtë Marrëveshje të Përgjithshme janë të përjashtuara nga Taksat e Tjera. Në rastin e Taksave të Tjera, nëse kostoja e një Takse Tjetër i ngarkohet ose bartet nga Shitësi të Blerësi, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën e Taksës Tjetër; me kusht që shuma e Taksës Tjetër të identifikohet veçmas në faturën e lëshuar nga Shitësi dhe të merret konfirmimi nga Blerësi, aty ku është e aplikueshme, që shuma e Taksës Tjetër është paguar ose kontabilizuar sipas rregullave duhur tek autoriteti Tatimor përkatës, sipas rastit.
3. **Detyrimi tatimor i shitësit dhe blerësit:** Shitësi do të paguajë ose do të bëjë që të paguhet i gjithë Tatimi mbi ose në lidhje me energjinë elektrike të lëvruar sipas një Kontrate Individuale që rrjedh përpara transferimit të rrezikut dhe titullit në Pikën e Lëvrimit. Blerësi do të paguajë ose do të bëjë që të paguhet i gjithë Tatimi mbi ose në lidhje me energjinë elektrike të lëvruar sipas një Kontrate Individuale që rrjedh pas transferimit të rrezikut dhe titullit në Pikën e Lëvrimit. Në përputhje me pikën 13.2, Palët do të paguajnë të gjitha Taksat që rrjedhin nga transferimi i rrezikut dhe titullit në Pikën e Lëvrimit në përputhje me ligjet vendore në fuqi. Në rast se Shitësi kërkohet me ligj të paguajë çdo Taksë që është në rregull për llogarinë e Blerësit, Blerësi do ta dëmshpërblejë ose rimbursojë menjëherë Shitësin në lidhje me këtë Taksë. Në rast se Blerësi i kërkohet me ligj të paguajë çdo Taksë që është në rregull për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund ta zbresë shumën e këtyre taksave nga shumat që i detyrohen Shitësit sipas Marrëveshjes dhe Shitësi do ta dëmshpërblejë menjëherë ose do ta rimbursojë Blerësin në lidhje me çdo taksë që nuk zbritet në këtë mënyrë.

### § 14 Garancitë dhe Mbështetja me Kredi, Sigurimi i Performancës

1. **Garancitë dhe Mbështetja me Kredi:** Për të vlerësuar rrezikun e secilës Palë në lidhje me aftësinë kreditore të Palës tjetër dhe për të siguruar përmbushjen e menjëhershme të të gjitha detyrimeve që rezultojnë nga



kjo MP dhe nga Kontratat Individuale, përpara se të lidhin një Kontratë Individuale, Palët mund të bien dakord për rrethanat në të cilat Dokumentet e Mbështetjes me Kredi mund të kërkojnë të sigurohen për përfitimin e një Pale, duke përfshirë formën e Dokumenteve të Mbështetjes me Kredi, shumën e mbështetjes së kredisë dhe identitetin e një ose më shumë Ofruesve të pranueshëm të mbështetjes me kredit.

2. **Sigurimi i Performancës:** Kur një palë ("Pala Kërkuese") beson me mirëbesim se aftësia e Palës tjetër, Ofruesi i saj i Mbështetjes me Kredi ose Pala së saj Kontrolluese për të përmbushur detyrimet e saj sipas Marrëveshjes, çdo Dokumenti të Mbështetjes me Kredi ose ndonjë marrëveshje kontrolli dhe transferimit të fitimit, sipas rastit, është dëmtuar materialisht, Pala Kërkuese do të ketë të drejtë të kërkojë, përmes njoftimit me shkrim, që Pala tjetër t'i japë asaj ose të rrisë shumën: (a) një letër kredie (rezervë). ; (b) para të thata; ose (c) garanci të tjera (duke përfshirë garancinë bankare ose të shoqërisë mëmë), në një formë dhe shumë të arsyeshme dhe të pranueshme për Palën Kërkuese (secila "Sigurimi i Performancës"). Pas marrjes së njoftimit me shkrim, Pala tjetër do t'i japë Palës Kërkuese Garancinë e kërkuar të Performancës brenda tre (3) Ditëve të Punës.

## **§ 15 Transferimi**

Asnjëra palë nuk do të ketë të drejtë t'i kalojë dhe/ose transferojë të drejtat dhe detyrimet e saj sipas Marrëveshjes një pale të tretë ose një Filiali.

## **§ 16 Konfidencialiteti**

1. **Detyrimi për konfidencialitetin:** Në përputhje me pikën 16.2, asnjë Palë nuk do t'i zbulojë kushtet e një Kontrate Individuale ("Informacion Konfidencial") një pale të tretë.
2. **Përrjashtimet nga informacioni konfidencial:** Informacioni konfidencial nuk përfshin informacione që:
  - (a) Bëhen publike me pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër;
  - (b) një Palë ia përhap Operatorit të Rrjetit, drejtorëve të tij, punonjësve, Filialeve, agjentëve, këshilltarëve profesionistë, bankës ose institucioneve të tjera financiare, agjencive të vlerësimit ose përfituesit të synuar, me kusht që kjo Palë t'i kërkojë përfituesit të synuar që ta trajtojë Informacionin Konfidencial si konfidencial në favor të Palës tjetër me kushte në thelb të njëjta me ato të parashikuara në këtë klauzolë;
  - (c) bëhet publik në përputhje me çdo ligj, rregullore ose rregull në fuqi të çdo shkëmbimi, operatori sistemi ose organi rregullator, ose në lidhje me ndonjë procedurë gjyqësore ose rregullatore; me kusht që secila Palë, për aq sa është praktike dhe e lejueshme sipas këtij ligji, rregulloreje ose rregulli, do të përdorë përpjekje të arsyeshme për të parandaluar ose kufizuar përhapjen dhe do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër lidhur me këtë çështje;
  - (d) është në ose hyn në mënyrë të ligjshme në domenin publik dhe nuk përbën shkelje të pikës 19.
3. **Mbarimi i Afatit:** Detyrimi i një Pale në lidhje me një Kontratë Individuale sipas pikës 18 do të përfundojë një (1) vit pas mbarimit të afatit të një Kontrate Individuale.

## **§ 17 Deklaratat dhe garancitë**

Secila palë në këtë Marrëveshje deklaron dhe e garanton palën tjetër menjëherë pas lidhjes së MP-së dhe sa herë që lidh një Kontratë Individuale si më poshtë:

1. në lidhje me një Palë, se kjo e fundit nuk është e falimentuar, dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor ose administrativ të lënë pezull ose të kërcënuar, në të cilin ajo është palë, të cilat sipas njohurive do të ndikojnë negativisht në aftësinë e saj për të përmbushur Kontratat Individuale sipas Marrëveshjes ose çdo Dokumenti të Mbështetjes me Kredi, në të cilin është palë, në mënyrë që të mund të bëhet e paaftë për të paguar;
2. ka negociuar, lidhur dhe ekzekutuar Marrëveshjen dhe çdo Dokument për Mbështetjen me Kredi në të cilin është palë si principal (dhe jo si agjent ose në çfarëdo cilësie tjetër, administratori të besuar ose ndryshe);
3. ajo vepron për llogari të tij (dhe jo si këshilltar, agjent, ndërmjetës ose në ndonjë cilësi tjetër, administrator i besuar ose ndryshe), ka marrë vendimin e vet të pavarur për të lidhur këtë Marrëveshje dhe çdo Kontratë Individuale dhe nëse kjo Marrëveshje dhe çdo Kontratë Individuale është e përshtatshme ose e duhur sepse ajo, bazuar në gjykimin e saj, nuk mbështetet në këshillat ose rekomandimet e Palës tjetër për ta bërë këtë, dhe është në gjendje të vlerësojë meritat e, dhe kupton dhe pranon termat, kushtet dhe rreziqet e Marrëveshjes; dhe
4. Ka selinë e saj, një qendër biznesi, një degë ose të ngjashme, sipas rastit, në Shqipëri.

#### § 18Të ndryshme

1. **Regjistrimi i Bisedave Telefonike:** Secila palë ka të drejtë të regjistrojë bisedat telefonike të ruajtura në lidhje me Marrëveshjen dhe t'i përdorë si provë. Secila Palë heq dorë nga çdo njoftim i mëtejshëm lidhur me këto regjistrime dhe pranon se ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme të nëpunësve dhe punonjësve të saj lidhur me regjistrimin.
2. **Njoftimet dhe Komunikimet:** Të gjitha njoftimet, deklaratat ose faturat që njëra Palë i dërgon Palës tjetër do të jenë me shkrim dhe do të dorëzohen me letër, postë elektronike ose faks në adresat dhe numrat e parashikuar në aneksin 3 të kësaj MP. Secila Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit të saj duke vënë në dijeni me shkrim Palën tjetër.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, çdo ndryshim ose shtesë në këtë MP do të bëhet vetëm me shkrim dhe të nënshkruhet nga të dyja Palët.
4. **Pavlefshmëria e Pjesshme:** Në rast se, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj MP ose Kontrate Individuale është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj MP ose të ndonjë Kontrate Individuale, nuk do të ndikohen ose cenohen në çfarëdo mënyre prej tyre. Palët marrin përsipër të zëvendësojnë çdo dispozitë të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që i afrohet sa më shumë dispozitave të pavlefshme për sa i përket qëllimit të saj ekonomik dhe dispozitave të Marrëveshjes së Përgjithshme të Federatës Evropiane të Tregtarëve të Energjisë (EFET).

#### § 19Ligji në fuqi dhe Arbitrazhi

1. **Ligji mbizotërues:** Kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe rregullohet nga ligjet e pavarura shqiptare.





2. **Arbitrazhi:** Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje ose mospajtim që lind në lidhje me Marrëveshjen, duke pasur parasysh se çdo mosmarrëveshje ose pretendim i mbetur i çdo lloji do t'i referohet për zgjidhje gjykatës kompetente në Tiranë, Shqipëri ose në përputhje me rregullat zvicerane të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomave të Tregtisë Zvicerane në fuqi në datën kur bëhet depozitimi i Njoftimit të Arbitrazhit në përputhje me këto Rregulla. Selia e arbitrazhit do të jetë në Gjeneva.

Ekzekutohet nga përfaqësuesi i autorizuar i secilës palë, i cili hyn në fuqi nga Data e Hyrjes në Fuqi.

**KESH-sh.a.**

Tiranë, \_\_/\_\_/\_\_\_\_

\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Emri:

\_\_\_\_\_  
Emri:

Titulli:

Titulli:

**Anekset:**

- Aneksi: Përkufizime
- Aneksi 2: Formularët e Konfirmimit për Kontratat Individuale
- Aneksi 3: Informacioni i njoftimit



## Aneksi 1

### **i Marrëveshjes së Përgjithshme për Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike Përkufizimet**

Termat e përdorur në këtë MP do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Marrëveshje" ka kuptimin e specifikuar në pikë 1.1;

"Ditë pune" është një ditë (përveç të shtunës ose të dielës) në të cilën bankat tregtare janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku ndodhet selia e regjistruar e secilës Palë;

"Blerësi" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

"Konfirmim" ka kuptimin e specifikuar në pikën 3.2;

"Kapaciteti kontraktor" nënkupton, në lidhje me një Kontratë Individuale, kapacitetin e rënë dakord ndërmjet Palëve të shprehur në MW;

"Çmimi i kontratës" nënkupton, në lidhje me një Kontratë Individuale, çmimin e rënë dakord ndërmjet Palëve;

"Sasia e Kontratës" nënkupton, në lidhje me një Kontratë Individuale, sasinë e rënë dakord ndërmjet Palëve, e shprehur në MW/h;

"Kontroll" nënkupton pronësinë e më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të fuqisë votuese të një Pale ose Subjekti dhe "E Kontrolluar" ose "Kontrollues" do të interpretohet në përputhje me rrethanat;

"Dokumentet e Mbështetjes me Kredi" mund të përfshijnë, pa kufizim, një garanci mëmë, garanci bankare, letër ndërgjegjësimi, letër kredie ose ndonjë marrëveshje për mbështetje me kredi;

"Ofruesi i Mbështetjes me Kredi" ka kuptimin e specifikuar në lidhje me një Palë të specifikuar në pikën 14;

"Pala në mospërbushje" ka kuptimin e specifikuar në pikën 8;

"Pika e Lëvrimit" nënkupton, në lidhje me një kontratë individuale, pikën e dorëzimit të rënë dakord ndërmjet Palëve;

"Plani i Lëvrimit" nënkupton, në lidhje me një Kontratë Individuale, planin e lëvrimit të rënë dakord ndërmjet Palëve;

"Forca Madhore" ka kuptimin e specifikuar në pikën 6.1;

"Kontratë individuale" ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (Subjekti i kësaj Marrëveshjeje Tregtare Individuale);

"Operator i Rrjetit" nënkupton së bashku ofruesit përkatës të transmetimit dhe operatorët e rrjetit, rrjetit elektrik ose sistemit;

"Palë që nuk është në mospërbushje" ka kuptimin e specifikuar në pikën 8;

"Pala kërkuese" ka kuptimin e specifikuar në pikën 14;

"Shitës" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

"TVSH" është çdo taksë mbi vlerën e shtuar ose çfarëdo analoge tatimore lidhur me të, por duke përjashtuar çdo interes ose gjobë të pagesës së detyrueshme të vonuar;



## Aneksi 2

### i Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë për Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike

#### Modeli - Konfirmimi i Kontratës Individuale

**Data e Tregtisë:**

**Numri i Referencës:**

**Shitësi:**

**Blerësi:**

#### Detajet e marrëveshjes:

| Fillimi i Lëvrimit | Përfundimi<br>Lëvrimit | i Kapaciteti<br>kontraktor | Çmimi i Kontratës<br>(EUR/më/h) |
|--------------------|------------------------|----------------------------|---------------------------------|
|--------------------|------------------------|----------------------------|---------------------------------|

**Totalet:**

**Vëllimi Total:**

**Shuma Totale:**

**Tipi i Kontratës:** çmim fiks

**Zona kohore:** GMT+1

**Pika e Lëvrimit:**

**Plani i Lëvrimit:**

**CBC: Siguruar nga**

#### Kushtet e kontratës:

Me anë të këtij konfirmimi vërtetohet Kontrata Individuale e lidhur në përputhje me Marrëveshjen Individuale të Tregtisë për Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike, të nënshkruar nga Palët me datën e hyrjes në fuqi \_\_\_\_\_, lidhur me lëvrimin e energjisë elektrike ndërmjet Palëve dhe shtojcave dhe është pjesë e asaj Marrëveshjeje Tregtare Individuale. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis kushteve të këtij Konfirmimi dhe Kontratës Individuale, ju lutemi na kontaktoni menjëherë.

(\_\_\_\_\_)

**Emri:**

**Emri:**

(\_\_\_\_\_)

**Emri:**

**Emri:**



### **Aneksi 3**

#### **i Marrëveshjes Tregtare Individuale për Lëvrimin dhe Pranimin e Energjisë Elektrike**

#### **informacioni i Njoftimit**

##### **DREJTUAR KESH:**

##### **Njoftimet dhe Korrespondenca**

Adresa:

Telefoni

Nr. i Faksit:

E-mail:

##### **Planifikimi dhe Konfirmimet**

Nr. i Faksit :

E-mail:

##### **Pagesat dhe Faturat**

E-mail:

Nr. i Regjistrimit të TVSH-së

Detajet e llogarisë bankare

Titullari i llogarisë bankare:

Nr. i Llogarisë Bankare:

##### **Shitja dhe blerja e energjisë elektrike**

Adresa:

E-mail:

Nr. i Faksit :

##### **Identifikimi i Logjistikës së Energjisë Elektrike:**

EIC (Kodet për identifikimin e energjisë elektrike):



**DREJTUAR \_\_\_\_\_:**

**Njoftimet dhe Korrespondenca**

Adresa:

Nr. i telefonit:

Nr. i Faksit:

Në vëmendje të:

**Faturat**

Nr. i Faksit:

Në vëmendje të:

Operacioneve Tregtare

**Pagesat**

Nr. i Regjistrimit të TVSH-së

Detajet e llogarisë bankare

Titullari i llogarisë bankare:

Nr. i llogarisë bankare

Kodi bankar:

SWIFT:

IBAN: (EUR)

**Konfirmimet**

Adresa

Në vëmendje të

Operacioneve Tregtare

Nr. i Faksit:

E-Mail për dërgimin e Konfirmimeve:

E-Mail për dërgimin e kundërshtimeve

ndaj Konfirmimeve:

**Identifikimi i Logjistikës Fizike të Energjisë**

Elektrike:

EIC (Kodet për identifikimin e energjisë elektrike):